



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Orahovac/Municipality of Rahovec



	REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO KUVENID I KOMUNËS/SKUPSTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY	
RAHOVEC /ORAHOVAC		
Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)		
Nr./Br./No <u>01/223</u> Nr. i faq/Br.str/No.pg <u>65</u>		
Data/Datum/Date <u>03</u> / <u>05</u> / <u>2024</u>		

PROGRAMI VJETOR I PUNËS
SË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA
TË KOMUNËS SË RAHOVECIT PËR VITIN 2024

Maj, 2024

Përmbajtja

Hyrje	3
Qëllimi	4
Mbledhjet.....	5
Tryeza	5
Vizitat.....	5
Aktivitetet Sensibilizuese	6
Trajnimet	6
Monitorimi I raportimi i planit të zbatimit te planit te veprimit.....	6

Hyrje

"Të gjithë njerëzit janë të lirë dhe lindin me të drejta dhe dinjitet të barabartë" - fillon neni 1 i Deklaratës së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. Këto të drejta i takojnë të gjithëve dhe janë të patjetërsueshme, pra nuk mund t'i mohohen askujt. Nisur nga këto parametra, e drejta për sigurim shëndetësor për shumicën dërrmuese të popullsisë mbetet "vetëm një ide e bukur".

Të kesh fëmijë me aftësi të kufizuar nuk është faji i askujt. Është e dhimbshme dhe e rëndë, por askush nuk është fajtor. Askush, as fëmija dhe as familja, nuk duhet të ndihet i turpëruar për këtë fakt. Asgjë në botë nuk do të jetë në gjendje të ndryshojë këtë fakt.

Në komunën e Rahovecit janë Rreth 1006 persona me aftësi të kufizuar,

Sigurimi i shëndetit nuk është një luks. Përkundrazi, është një domosdoshmëri kohore, sepse çdo ditë jemi të ekspozuar ndaj rreziqeve të paparashikueshme. Shëndeti "është një e drejtë themelore e njeriut e domosdoshme për ushtrimin e të drejtave të tjera" dhe çdo qenie njerëzore ka të drejtë të gëzojë "standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit për një jetë me dinjitet".

Qëllimi

Komiteti Komiteti për Persona me Aftësi të Kufizuara i Komunës së Rahovecit është përzgjedhur nga Kuvendi Komunal i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2024. Ky komitet ka për qëllim adresimin e çështjeve të qytetarëve tek zyrtarët komunal.

Funksionet që do të kryhen nga ky komitet do të jenë: dhënia e propozimeve të nryshme tek autoritetet komunale, hulumtime te ndryshme, do të japë mendime dhe ide rreth iniciativave të marra nga kryetari i komunës, paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve te kryetari i komunës, dhe do të japë propozime për zgjidhjen e problematikave të identifikuar.

Ky komitetet ka për fushëveprim nxitjen, mbrojtjen dhe sigurimin e mundësisë që të gjithë Personat me Aftësi të Kufizuara në territorin e Komunës së Rahovecit t'i gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre, sa u përket specifikave të këtyre personave dhe sa i përket domenit të nivelit komunal të qeverisjes.

Realizimi i këtij programi do të sigurojë që Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Rahovecit të kenë një adresë të caktuar në të cilën t'i ngrisin çështjet me të cilat ata ballafaqohen në jetën e tyre të përditshme. Kjo do të arrihet edhe përmes formësimit dhe fuqizimit të rolit të Komitetit, i cili përherë do të ketë për target Personat me Aftësi të Kufizuara në tërë territorin e Komunës së Rahovecit dhe do të merret ekskluzivisht me problemet e tyre

Për të arritur qëllimin e tij, është punuar Plani i Punës Një vjekar i Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuar në Komunën e Rahovecit.

Mbledhjet

Bazuar në Nenin 11 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016 për Procedurën e themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative, në Komuna do të organizohen së paku 6 mbledhje në vit, varësisht nga nevojat.

Për vitin 2024, mbledhjet do të mbahen në muajt Mars, Maj, Qershor, Tetor, Nëntor, Dhjetor.

Tryeza

Komiteti do të organizojë së paku një tryezë të rrumbullaktë, me qëllim të identifikimit dhe diskutimit të çështjeve me të cilat ballafaqohen Personat me Aftësi të Kufizuara në përgjithësi dhe që janë në kompetenca të komunës për tu zgjidhur.

Për këtë vit, Komiteti organizon tryezë të rrumbullaktë.

Pjesëmarrës në këtë tryezë do të ftohen të jenë përfaqësues institucionesh publike, organizatat joqeveritare komunitare, si dhe të shoqërisë civile që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Komiteti do të nxjerrë dhe publikojë konkluzionet e dala nga kjo tryezë.

Vizitat

Për vitin 2024, me qëllim të njohjes sa më të mirë të kushteve dhe rrethanave të personave me aftësi të kufizuara në komunën e Rahovecit dhe senzibilizimin e qështjes, Komiteti Konsultativ do të realizojë një sërë vizitash me:

1. Institucionet komunale – me qëllim të rritjes së involvimit të tyre në përmirësimin e infrastrukturës ligjore, pastaj senzibilizimin e qështjes tek autoritetet komunale. Poashtu, do të trajtohen edhe organizimet e ndryshme kultore, sportive dhe forma të tjera që do të organizohen së bashku me autoritetet komunale.
2. Organizatat joqeveritare që meren me qështjet e aftësisë së kufizuar – me qëllim të identifikimit të të problemeve dhe për t'i dëgjuar kërkesat dhe propozimet e tyre në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të caktuara të nivelit komunal të qeverisjes. Do të bëhet njohja nga afërt e punës ditore të këtyre organizatave me personat me aftësi të kufizuar dhe aktivitetet që mbahen në këto qendra, Poashtu do të diskutohet bashkëpunimi i vazhdueshëm ndërmjet Komitetit Konsultativ dhe këtyre organizave. Realizimet e këtyre vizitave do të bëhen në bazë të korrdinimit me organizatën për kohën e takimit.
3. Komitet konsultativ të një komune tjetër me qëllim të shkëmbimit të përvojave të komitetit në komunën përkatëse.
4. Vizitat në shkollat speciale apo në shkolla ku vijnë mësimin fëmijët me aftësi të kufizuar – me qëllim të njohjes nga afër të gjendjes në të cilën ata marrin mësimin.
5. Komitet konsultativ do të marrë pjesë në vizite studimore jashtë shteti – do të realizojë një vizitë në një nga vendet në rajon ose më gjerë, me qëllim të këmbimit të përvojave, në organizimin dhe rolin e entiteteve të aftësisë së kufizuar atje, si dhe me pjesëmarrjen aktive të komunitetit të aftësisë së kufizuar në rrjedhat shoqërore dhe jetën publike.

Aktivitetet Senzibilizuese

Shënimi i Ditës Ndërkombëtare për Persona me Aftësi të Kufizuara

Gara në ndonjë sport (shah apo ndonjë lojë tjetër)

Gjatë këtijë viti do të mbahen aktivitete të ndryshme për shënimin e ditëve botërore të ndryshme.

Trajnimet

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve, do të tentohet që anëtarët e këtij komiteti të marrin pjesë në ndonjë trajnim në Kosovë të ofruar nga organizatat e ndryshme vendore apo ndërkombetare. Poashtu në rast të organizimit të ndonjë trajnimi jashtë vendi, do të tentohet të marrim pjesë. Treajnimet do të jenë të kushtëzuara, duke u bazuar në mundësitë buxhetore për ti ndjekur këto trajnime.

Monitorimi i raportimi i planit të zbatimit të planit të veprimit

Monitorimi i planit të punë do të përfshijë zbatimin në praktikë të konkluzioneve dhe rekomandimeve të nxjerra nga mbledhjet e Komitetit dhe të konkluzioneve dhe të rekomandimeve të nxjerra nga realizimet e tryezave të rrumbullakëta dhe realizimet e vizitave me organizatat lokale.

Komiteti për të gjitha punët dhe aktivitetet e veta, do të bëjë raportime në baza vjetore me shkrim të Kuvendi Komunal i Rahovecit. Këto raportime do të raportohen edhe në Faqen Zyrtare të Komunës së Rahovecit.

01 Nr. ____/24
Datë:03.05.2024

 Almedina Jaha
Kryesuese e Kuvendit